

Thirrje për punë praktike në Fondin për të Drejtën Humanitare Kosovë



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) i fton të gjithë studentët (të vitit të tretë dhe të katërt të studimeve) të Fakultetit Juridik (publik dhe kolegjeve private), që të aplikojnë për punë praktike në monitorimin e gjyqimeve për krimet e luftës në Kosovë. Kohëzgjatja e praktikës do të jetë prej tre (3) deri në gjashtë (6) muaj.

Gjatë periudhës së praktikës, studentë do të kenë mundësi që të marrin pjesë dhe të monitorojnë seancat për krimet e luftës në Kosovë pranë gjykatave të Kosovës dhe Dhomave të Specializuara të Kosovës, si dhe të mësojnë më shumë për proceset e drejtësisë tranzicionale për gjatë punës në FDHK.

FDHK do t'i mbulojë shpenzimet e studentëve të cilët do të angazhohen në monitorimin e këtyre seancave gjyqësore.

Dokumentet e nevojshme:

- CV
- Letër motivuese
- Çertifikata e notave

Si të aplikoj:

- Studentët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e kërkuara në email-in office@.
- Vetëm studentët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në

intervistë.

Kriteret për zgjedhjen e kandidatëve:

- Studentët duhet të jenë në vitin e tretë ose të katërt të studimeve bachelor në Fakultetin Juridik, megjithatë studentët në vitin e fundit të studimeve të cilët janë profilizuar në drejtimin penal dhe të drejtës ndërkombëtare do të kenë përparësi;
- Studenti/ja duhet t'i ketë përfunduar provimet në të drejtën penale dhe procedurën penale;
- Nota mesatare duhet të jetë mbi 7.5;
- Njohja e gjuhës serbe dhe angleze është një përparësi;
- Studentët të cilët deri më sot nuk kanë kryer ndonjë punë praktike, si dhe studentë nga komunitete të ndryshme që jetojnë në Kosovë inkurajohen që të aplikojnë.

Nëse keni ndonjë pyetje, jeni të mirëseardhur që t'i drejtoheni Nesa Kepuska përmes email-it nesa@.

Afati i fundit për paraqitjen e aplikacioneve është 24 Shkurt 2023.

-Poziv za stažiranje pri Fondu za humanitarno pravo Kosovo

-Public call for internship at Humanitarian Law Center Kosovo